



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008, të nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja b, nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2022, miratoi këtë

V E N D I M

1. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë LIROHEN nga obligimi për tarifat në transaksion të pronës, të përcaktuara sipas Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011 dhe Rregullores, 01-431/04-0253431/17 (KPR) për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011.
2. Lirimi sipas pikës 1 të këtij vendimi, vlen për periudhën kohore, nga data 01 janar 2023 deri më 31 dhjetor 2023.
3. Ky vendim merret me qëllim që t'u krijohet mundësia personave fizikë dhe juridikë, që gjatë kësaj periudhe kohore t'i bartin pronat në emër të tyre, duke u liruar nga detyrimi i pagesës së tarifës së transaksionit për periudhën e specifikuar në pikën 2 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës dhe fillon të zbatohet nga data 01 janar 2023.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-435/02-257523/22, më 25.11.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

